

VENDIM
Nr. 120, datë 22.2.2012

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 33, DATË 19.1.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURËN E SHQYRTIMIT, NGA KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK, TË ANKESAVE NDAJ PROCEDURAVE TË ANKANDIT APO VENDIMEVE PËR PËRJASHTIM NGA KËTO PROCEDURA” DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1719, DATË 17.12.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ANKANDIT PUBLIK””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 42/1 të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores bashkëlidhur vendimit nr. 33, datë 19.1.2011 të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas nenit 2 “Përkufizime”, të kreut I, shtohet neni 2/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 2/1

Baza juridike për funksionimin dhe veprimtarinë e Komisionit

Komisioni i Prokurimit Publik funksionon dhe ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Kushtetutën, me ligjin nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, me aktet e tjera, ligjore dhe nënligjore, si dhe me këtë rregullore.”.

2. Neni 10 “Rregulla të përgjithshme procedurale” i kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 10

Rregulla të përgjithshme

1. Për çdo çështje të ankimuar, kryetari apo, në mungesë të tij, zëvendëskryetari, cakton me short si relator një nga anëtarët e tij, duke siguruar shpërndarjen e barabartë të çështjeve ndërmjet anëtarëve.

2. Për çështje të ankimuar, me vlerë fillestare më të lartë se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, kryetari apo, në mungesë të tij, zëvendëskryetari, cakton me short si relator tre nga anëtarët, duke siguruar shpërndarjen e barabartë të çështjeve ndërmjet tyre. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, në rast se ka mendime të ndryshme ndërmjet relatorëve, projektvendimi hartohet sipas mendimit të shumicës së tyre.

3. Rregullat për njohjen me aktet, për përjashtimin e kryetarit, anëtarëve, inspektorëve, ekspertëve dhe specialistëve të pavarur, në kushtet kur gjenden në një nga rastet e konfliktit të interesit, si dhe për pjesëmarrjen dhe detyrat e inspektorëve në shqyrtimin e një ankimi sipas ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008, janë të njëjta me ato të përcaktuara në rregulloren e prokurimit publik.”.

3. Në pikën 1 të nenit 18 “Përmbajtja e vendimit”, të kreut II, pas fjalëve “... vulën e Komisionit ...” shtohen fjalët “... anëtarët e pranishëm në mbledhje, relatorin e çështjes, votimi kundër ...” dhe pas fjalisë së parë shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Gjithashtu, çdo anëtar ka të drejtë të kërkojë që arsyetimi i mendimit kundër ose konkurrues t’i bashkëlidhet vendimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha